AKADEMIA • ACADEMY
TEMPULLI

RREGULLORJA PËR KËSHILLIN STUDENTOR TË AKADEMISË TEMPULLI

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1
Emërtimi i Organizimit

Emërtimi i organizatës studentore do të jetë: **Këshilli Studentor i Akademisë Tempulli**

Neni 2
Përkufizime

KSKT është Këshilli Studentor i Akademisë Tempulli.
KS është Këshilli Studentor;
"KZ" është Komisioni i Zgjedhjeve;
"Këshilltar Studentor" quhet studenti i zgjedhur nga trupa zgjedhore e studentëve, bazuar në nenin 42 të Statutit të KT, për të përfaqësuar degën e një viti ne KSKT dhe para organeve vendimmarrëse të Akademisë Tempulli.
Kuorum" quhet prania e 50%+1 e të gjithë anëtarëve të organit përkatëse.

Neni 3
Qëllimi dhe objektivat

Këshilli Studentor i Akademisë Tempulli ka si qëllim të tij që:

- Të trajtojë shqetësimet e studentëve dhe të veprojë për zgjidhjen e tyre;
- Të kontribuojë në rritjen e aftësive organizuese dhe administruese të grupeve më aktive të studentëve;
- Të krijojë struktura që shërbejnë për informimin e studentëve dhe të kujdeset për mbarëvajtjen e tyre;
- Të bashkëpunojë me organet drejtuese të Akademisë me synim përmirësimin e nivelit mësimor e kërkimor-shkencor;
- Të krijojë e përforcojë lidhjet midis studentëve të Akademisë dhe studentëve të Institucioneve tjera të Arsimit të Lartë në Kosovë dhe vendet tjera në rajon dhe botë;
- Të ndërmarrë veprime që do të ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes së studentëve;
- Të krijojë struktura ndihmëse në zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore për studentët;
- Të ofrojë shërbime lehtësuese për studentët;
- Të zhvillojë niveli kulturor dhe arsimor të studentëve;
- Të kryejë aktivitete që synojnë argëtimin në format e tij më të larmishme.

Neni 4

Zyra e këshillit studentor të Akademisë Tempulli

Zyra e (KSKT) ndodhet në katin e lartë te objektit të Akademisë Tempulli. Zyra dhe pajisjet që ndodhen në të administrohen nga kryetari. Zyra mund të përdoret edhe nga persona të tjerë, autorizimi i të cilëve bëhet nga kryetari. Çdo person i autorizuar për të përdorur zyrën e (KSKT) dhe pajisjet që ndodhen në të mban përgjegjësi individuale për dëmtimet materiale që mund të shkaktojë.

Neni 5

Pavarësia

Këshilli Studentor i Akademisë Tempulli është një organizëm jo politik, të cilit i ndalohet çdo lloj bashkëpunimi me parti politike dhe organizata politike. Të gjithë këshilltarëve studentor, sekretarit të përgjithshëm, përgjegjësive te departamenteve, anëtarëve të Komisionit të Zgjedhjeve, anëtarëve të komisioneve që ngrihen nga KS dhe anëtarëve të grupeve të punës që ngrihen nga strukturat e (KSKT) u ndalohet prononcimit politik=publik, në emër të Këshillit Studentor të Akademisë Tempulli apo strukturave të tij.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrat e studentëve ne marrëdhënie me KSKT

Çdo student, pasi ka depozituar kërkesën me shkrim te këshilltari studentor dhe ky i fundit, pranë Mësimdhënësit dhe ka marrë autorizim nga Përgjegjësi i Departamentit për të shtruar në rend dite një çështje të caktuar, ka të drejtë të shfaqë mendimet e tij, të diskutojë në mbledhjet e KS, të kërkojë llogari për menaxhimin e fondeve/

- Çdo student ka të drejtë të informohet mbi veprimtarinë e KSKT
- Gjithashtu çdo student ka për detyrë që në marrëdhëniet me KSKT të zbatojë me rigorozitet statutin e KSKT.

Neni *7*

Këshilli studentor – KS

KS është organi kolegjial, vendimmarrës, më i lartë i KSKT.

Anëtarët e KS quhen këshilltar studentor dhe zgjidhen çdo 3 vjeçar nga komuniteti studentor i i Tempullit. KS mblidhet një herë në 5 javë.

Mbledhjet e KS janë të vlefshme kur në to janë njoftuar publikisht të gjithë këshilltarët, pavarësisht nga numri i pjesëmarrësve ne mbledhje. Mbledhjet e KS drejtohen nga kryetari i KSKT.

Përveç rasteve që statuti parashikon ndryshe, vendimet e KS merren me shumicën e thjeshtë te votave të këshilltarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast se votat janë të barabarta vota e kryetarit të KS konsiderohet vendimtare në marrjen e vendimeve. Vendimet e KS merren vetëm kur ne mbledhje ka kuorum.

Vendimi për shkarkimin e kryetarit merret me votim te fshehtë, me 3/5 e votave të të gjithë këshilltarëve.

Vendimet e KS hyjnë në fuqi menjëherë pasi firmosen nga kryetari.

KS ka këto kompetenca:

- Zgjedh ose shkarkon kryetarin me votim të fshehtë;
- Shkarkon këshilltarin me votim të fshehtë;
- Mandaton kryetarin;
- Krijon komisione të përhershme ose të përkohshme për çështje të ndryshme dhe përcakton mënyrën e funksionimet të tyre.
- Vendos për krijimin e marrëdhënieve me klubet studentore me synim bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellët.
- Shpall datën e fillimit te fushatës zgjedhore brenda afatit të përcaktuar në statut;
- Shpall datën e zgjedhjeve te përgjithshme brenda afatit të përcaktuar në statut;
- Merr në shqyrtim dhe vendos për propozimet që bëhen nga organizma dhe organizata të detyrueshme me qëllim bashkëpunimi e ndihme të ndërsjellët;
- Miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të KSKT;
- Diskuton çdo gjë të jashtëzakonshme që vihet në rendin e ditës të mbledhjes dhe merr vendime rreth saj.

Neni 8

Kryetari i KSKT

Kryetari duhet te jete këshilltar i KSKT.

Kryetari ka mandat tre vjeçar dhe ushtron kompetencat e tij deri në zgjedhjen dhe mandatimin e kryetarit të ri.

Kryetari zgjidhet nga KS një here ne vit dhe ka këto kompetenca:

- Drejton veprimtarinë e KSKT në bazë të statutit;
- Hyn në marrëdhënie me organizma, organizata apo institucione të tjera pas vendimit të marrë nga Këshill Studentor.
- Përgatit, thërret dhe drejton mbledhjen e Këshillit.
- Përcakton rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit studentor.
- Përgatit, thërret dhe drejton mbledhje të jashtëzakonshme të KS
- Kujdeset për interesat e KSKT, i mbron ato si dhe përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.
- Delegon tërësisht ose pjesërisht kompetencat e tij tek zv/kryetari.
- Nënshkruan vendimet e KSKT-së.
- Përgatit projekt programin vjetor të aktiviteteve dhe e paraqet për miratim tek Studentët;
- Merre në shqyrtim propozimet që bëhen nga institucione dhe organizata të ndryshme me qëllim bashkëpunimi e ndihme të ndërsjelltë.
- Koordinon dhe zbaton vendimet e marra prej KS-së dhe Autorizon persona të ndryshëm të marrin pjesë në mbledhjen e KS me të drejtën e fjalës ose jo, duke i futur ose jo në rendin e ditës.

KSKT ka nje zv/kryetar. Zv/kryetari i **KSKT** zgjidhet nga **KS**. Zv/kryetari i KSKT ka mandat një vjeçar dhe ushtron kompetencat e tij deri në zgjedhjen dhe mandatimin e zv/kryetarit të ri.

Kompetencat e zv/kryetarit janë:

Merr pjesërisht ose tërësisht kompetencat e kryetarit me deklarim të shkruar të këtij të fundit. Në rastet kur kryetari humbet mandatin si, shkarkohet ose jep dorëheqjen zv/kryetari. Në rast mungese të kryetarit drejton mbledhjen e KS.

Neni 9

Mandatimi

Mandatimi i anëtarit të KS kryhet nga Komisioni i Zgjedhjeve. Mandatimi i kryetarit të KSKT kryhet nga Këshill Studentor.

Neni 10

Komisioni i zgjedhjeve

Komisioni i Zgjedhjeve krijohet me zgjedhje nga Këshill Studentor të paktën një muaj para shpalljes së datës së fillimit të fushatës zgjedhore. Mandatimi i KZ bëhet nga KS dhe zgjat deri 1 muaj pas përfundimit të gjithë procesit të zgjedhjeve të përgjithshme dhe të brendshme të KSKT. Anëtarët e KZ janë kryetari i komisionit dhe katër studentë të Akademisë , dy nga secilit Kolegj. Anëtarët e KZ propozohen nga sekretari i përgjithshëm. Katër anëtarët e KZ votohen një nga një prej Këshill Studentor. Anëtari i KZ që është edhe kryetar i KZ zgjidhet si i tillë nga KS.
Kryetari i KZ drejton mbledhjen e këshill në të cilën zgjidhet kryetari i ri t KSKT
Anëtarët e KZ duhet të jenë studentë të Akademisë të cilët nuk janë ë dhe nuk kandidojnë për t'u bërë anëtarë.
Mbledhjet e KZ janë të vlefshme kur në to janë ftuar të pestë anëtarët dhe marrin pjesë në to jo më pak se tre anëtarë (kryetari + dy anëtarë). Mbledhjet e KZ thirren dhe drejtohen nga kryetari i KZ. Vendimet e KZ merren me shumicë votash. Në rast se votat janë të barabarta vota e kryetarit të KZ konsiderohet vendimtare në marrjen e vendimeve.

KZ ka këto kompetenca:

- Organizon zgjedhjet e pjesshme, të përgjithshme dhe të brendshme për KSKT.
- Numëron votat dhe shpall fituesit.
- Shqyrton ankesat e palëve të ndryshme dhe kur e shikon të arsyeshme, jo më vonë se 48 orë, merr vendim për përsëritjen e procesit zgjedhor në mënyrë të pjesshëm ose tërësore.
- Mandaton kandidatët për që kanë fituar zgjedhjet, jo më vonë se një javë nga dlta e përfundimit të zgjedhjeve.

Neni 12

Mënyrat e votimit

Mënyrat e votimit në KSKT janë:

- Votim i hapur;
- Votim i fshehtë.
- Votim i hapur bëhet duke ngritur dorën.

- Votim i fshehtë bëhet në rastet kur thuhet shprehimisht në statut dhe kur kërkohet nga jo më pak se 1/3 e pjesëmarrësve në votim.

Neni 13
Zgjedhjet

Zgjedhjet e përgjithshme për riformimin e Këshillit Studentor bëhen njëherë në dy vjet, zgjedhjet duhet të zhvillohen në fillim te vitit akademik. Zgjedhjet e përgjithshme duhet të fillojnë jo më vonë se java e tretë e muajit përkatës. Zgjedhjet e përgjithshme duhet të përfundojnë jo më vonë se java e katërt e muajit përkatës. Votimi në zonat elektorale bëhet i fshehtë, me kuti votimi transparente. Zgjedhja e studentëve bazohet në të drejtën e çdo studenti për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Data e fillimit të fushatës elektorale shpallet nga KS jo më vonë se java e dytë e muajit përkatës. Fushata elektorale vazhdon deri në përfundim të zgjedhjeve.

Dekani merrë masat për të vënë në dispozicion strukturat dhe personat, për ndihmese në organizimin teknik të zgjedhjeve për këshillin studentor. Njoftimi për datën e zgjedhjeve bëhet publik në mjediset e Akademisë. Sekretari i përgjithshëm duhet të marrë masat dhe sigurojë bazën materiale për zhvillimin e procesit të votimit.

"Çdo student ka të drejtën e votës për të zgjedhur këshilltarët studentor (1 student përfaqësues për 1 degë të çdo viti) të këshillit studentor te Akademisë . Çdo student pajiset me një fletë votimi standarde për degën e tij dhe në të shënon vetëm përkrah emrit të një kandidati, për çdo vit. Çdo student ka të drejtë të kandidojë për t'u zgjedhur këshilltar studentor (përfaqësues i degës së vitit të tij) në këshillin studentor të Akademisë .

Kryetari i këshillit studentor të Akademisë drejton në vazhdim mbledhjet e këshillit studentor. Këshilli studentor i Akademisë zgjedh përfaqësuesit e studentëve në këshillin e administrimit të Akademisë, në përputhje me statutet e shkollave të larta dhe rregulloret përkatëse. Kryetarët e këshillit studentor të së njëjtës shkollë të lartë universitare zgjedhin midis tyre kryetarin e këshillit Studentore të Akademisë dhe përfaqësuesit e studentëve në këshillin e Akademisë , sipas statuteve të shkollave të larta dhe rregulloreve përkatëse. Dekanati i Akademisë vë në dispozicion mjediset e Akademisë gjatë gjithë periudhës së zgjedhjeve, në funksion të zhvillimit të fushatës zgjedhore nga studentët kandidatë, e cila mund të përmbajë elementë të tillë si postera, takime në sallat e Akademisë. Procesi zgjedhor është i hapur dhe mund të monitorohet në çdo pjesë të tij.

Neni 13
Kandidimi për kryetar

Të drejtën e kandidimit për kryetar e ka çdo anëtar i KSKT.

Neni 14

Propozimi për Sekretar i përgjithshëm

Të drejtën për t'u propozuar si sekretar i përgjithshëm nga ana e kryetarit e ka ç'do student i Akademisë.

Neni 15

Shkarkimi kryetarit

Propozimi për shkarkimin e kryetarit mund të bëhet nga: 1/3 e të gjithë studentëve të Akademisë 1/3 e të gjithë këshilltarëve, Kryetari mund të shkarkohet vetëm me vendimin e 3/5 të të gjithë këshilltarëve të KSKT. Vendimi për shkarkimin e kryetarit merret pasi është kryer votimi i fshehtë nga këshilltarët.

Propozimi për shkarkimin e zv/kryetarit mund të bëhet nga: 1/3 e të gjithë këshilltarëve; Kryetari. Zv/kryetari mund të shkarkohet vetëm me vendimin e 3/5 të të gjithë këshilltarëve. Vendimi për shkarkimin e zv. kryetarit merret pasi është kryer votimi i fshehtë nga këshilltarët.

Propozimi për shkarkimin e sekretarit të përgjithshëm mund të bëhet nga: 1/3 e të gjithë këshilltarëve; Kryetari. Sekretari i Përgjithshëm mund të shkarkohet vetëm me vendimin e 3/5 të

të gjithë këshilltarëve. Vendimi për shkarkimet e Sekretarit të Përgjithshëm merret pasi është kryer votimi i fshehtë nga këshilltarët.

Neni 16

Shkarkimi i anëtarit

Propozimi për shkarkimin e këshilltarit studentor mund të bëhet nga: 1/5 e studentëve të zonës së tij elektorale; 1/3 e të gjithë këshilltarëve; Kryetari. i mund të shkarkohet vetëm me vendimin e 3/5 të të gjithë këshilltarëve studentore. Vendimi për shkarkimin e it merret pasi është kryer votimi i fshehtë nga këshilltarët studentore.

Neni 17

Humbja e mandatit

Këshilltari e humbet mandatin kur:

- Kryen me shumë se pesë mungesa te pajustifikuara ne mbledhjet e KS.
- Shkarkohet;
- Jep dorëheqjen;
- Merr tre vërejtje nga kryetari për shkelje të etikës gjatë mbledhjeve të KS ose për veprimtari në kundërshtim me statutin dhe interesat e KSKT.
- Sekretari i përgjithshëm e humbet mandatin kur:
- Nuk zbaton vendimet e KS dhe/ose kryetarit.
- Shkarkohet;
- Jep dorëheqjen.

AKADEMIA • ACADEMY

TEMPULLI